




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-15066/23 datë: 19.06.2023



Npi – 01/256 datë: 23.06.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 23.06.2023 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VI- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 23.06.2023 (e premte) në ora 09:00h në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: z.Grejtalb Emini Drejtor i DPUKGGJ-së, z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar, z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, praktikantët znj.Sadbere Halili, dhe znj.Valmira Hoxha. Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026, (Pas diskutimit Publik)
2. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri,
3. Propozim-Vendim për plotësimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/32 për ndarjen nga 100€ për Nënata-Lehona për vitin 2023,
4. Propozim-vendim për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K. numër P-03020-2 ZK-Shtime,
5. Propozim-Vendim për hapje të rrugës publike në Z.K – Karaqicë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026, (Pas diskutimit Publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Kjo pikë ka shkuar në diskutim publik. Janë mbajtur diskutimet sipas Itenerarit që ka qenë prezent nëpër fshatra e lagje urbane të Komunës së Shtimes. E kemi edhe z.Bujar Ferati, prezent për të na dhënë sqarime. Numri i të pranishmëve në disa fshatra nuk ka qenë i kënaqshëm por në disa po. Kemi edhe propozime konkrete për problemet dhe nevojat në fshatrat e Komunës tonë.

z.Bujar Ferati, ZKF; Përshëndetje, materialin e keni marrë me kohë dhe besojë e keni lexuar diskutimet janë mbajtur dhe kolegët e mi i kanë përcjellë diskutimet por unë nuk kam pasë mundësi kështu që propozimet do ti kompletojme dhe do ti sjellim në Kuvend më 06.07.2023. Besoj se këtu mund të na ndihmojë edhe Grejtalbi meqenëse ka marrë pjesë rregullisht në dëgjimet publike.

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ; Unë i falenderojë qytetarët që kanë marrë pjesë edhe në oraret e pa përshtatshme. Kemi marrë shumë kërkesa dhe propozime konkrete dhe ato do ti adresojmë në Kuvend, dhe do të bëhen gati si dokument.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, diskutimet publike gjithmonë kanë qenë të mangëta, e mira është që janë mbajtur në secilin fshat. Unë kam marrë pjesë si anëtarë i KPF-së. DPUKGJ-ja i din prioritetet. Konsideroj se si dokument duhet me kalu, dhe i rekomandojmë Kuvendit për miratim. Keni bërë një punë voluminoze dhe ju përgëzojë.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, draftin që e kemi marrë, disa kërkesa nuk janë përfshi sepse ka vazhduar diskutimi edhe më tutje kështu si draft unë nuk mundem me votu.

z.Përparim Ramusa; Nëse nuk janë të gjitha kërkesat atëherë ne dalim kundër vetvetës, ju falenderojë për diskutimet. Propozojë që me kalu direkt në Kuvend, pa rekomadim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë thashë se janë marrë të gjitha kërkesat. Por nuk thashë që janë futë të gjitha. Po e votojm Po e votojmë me arsyetimin që të bëhen plotësimet në materiale.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Ekzekutivit, që ta sjellë në seancën e Kuvendit më 27.06.2023 materialin e kompletuar me propozimet që kanë ardhur nga procesi i diskutimit publik me qytetarë.**

Pika 2

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF-së me anëtarë të ri

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Sqaroj dokumentin e Rekomadimit të MAPL-së për rishikimin e vendimit Npi-01/76. Unë kërkojë që ta respektojmë edhe Udhëzimin Administrativ edhe Ligjin, për ti hapë rrugë zgjedhjes së znj.Zejnije Velu për anëtare të KPF-së. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Kadri Emini; Mendoj se Rekomandimi i MAPL-së është i qartë. Unë edhe atëherë kam thënë se është vendim i kundërligjshëm, Zejnija e ka vullnetin dhe është e padrejtë që me penalizu dhe me ngelë KPF-ja pa një anëtarë. Dhe kushdo që zgjidhet jashtë kësaj është shkelje ligjore.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për Kuvendin me kthimin e vendimeve nga MAPL-ja është degradim i performancës së Kuvendit.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota “Për”, me 3 vota “Kundër dhe me 0 vota “Abstënim” (duke përdorur të drejtën e votës së dyfishtë të Kryesuesit) me 4 vota “Për” vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndryshimin e vendimit të Kuvendit, Npi-01/76, për plotësimin e KPF me anëtarë të ri, ashtu qysh e ka dhënë rekomandimin MAPL-ja.**

Pika 3

Propozim-Vendim për plotësimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/32 për ndarjen nga 100€ për Nënat-Lehona për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Kadri Emini; Ne jemi pro për me i dhënë nga 100 euro. Është mirë me pa ankesën e palës.

z.Përparim Ramusa; Ne e kemi vendimin për Nënat-Lehona, unë jam dakort për me ua dhënë 100 euro edhe këtyre Nënave-Lehona që nuk e kanë shtetësinë e Kosovës e që janë të martuara në Kosovë.

z.Lumni Amrush; Nuk e di a ka mundësi që me ja dhënë edhe Babait sepse ka raste specifike, po e përmendi si zgjidhje.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Vendim për plotësimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/32 për ndarjen nga 100€ për Nënat-Lehona për vitin 2023, me kërkesën që drejtori i DSHMS-së, me i specifikuar dhe me i prezantuar Kriteret për zbatimin e këtij vendimi, në seancën e Kuvendit më 27.06.2023.**

Pika 4

Propozim-vendim për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K. me numër P-03020-2, ZK-Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ; Nuk kam me shtu asgjë, vetëm po pres me u miratu sepse është stërzgatur shumë. Propozimi ka ardhur nga Rexhep Gashi.

znj.Adelina Beqaj; Ne kemi kërkuar një pëlqim nga Ministria?

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ; Nuk kemi nevojë me kërku pëlqim ngase e kemi një pëlqim të përgjithshëm.

z.Përparim Ramusa; Kërkojmë nga Zyrtari Ligjor që ta sjellë me shkrim në Kuvend se votimi i shëndrrimit të tokës kullosë në tokë ndërtimore nuk është shkelje Ligjore, pastaj ne e votojmë.

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ; Unë jam duke rekomanduar që kjo pikë të miratohet.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K. numër P-003020-2, ZK-Shtime, me kërkesën që drejtori i DPUKGJ-së të na sjellë me shkrim Rekomandimin për këtë pikë, në seancën e Kuvendit më 27.06.2023.**

Pika 5

Propozim-Vendim për hapje të rrugës publike në Z.K – Karaqicë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ; Edhe kjo pikë është diskutuar disa herë. Fjala është me hapë një rrugë në fshtin Karaqicë në pronën komunale.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin Vendimit për hapjen e rrugës publike në Z.K – Karaqicë.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime të tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 10:15h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

